



Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Tiranë, më 16 Nëntor 2021

## KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

### **SUBJEKT TREGTAR/KOMPANI QË OFRON REALIZIMIN E DESIGN, FAQOSJEN DHE PRINTIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT MBI ANGAZHIMIN E SHOQËRISË CIVILE NË PROCESET VENDIMMARRËSE DHE LEGJISLATIVE.**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në kuadër të implementimit të grantit të akorduar në zbatim të projektit “Për mbështetjen e Kuvendit dhe Edukimit Qytetar (PACEP)”, projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e zbatuar nga Prezenca e OSBE në Shqipëri dhe Instituti Demokratik Amerikan (NDI), shpall thirrjen për subjekt tregtar/kompani që ofron realizimin e design, faqosjen dhe printimin e Raportit të Vlerësimit mbi angazhimin e shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse dhe legislative.


**Ky raport do të ketë një numër faqesh deri në 120 faqe (+/- 10 faqe) dhe do të printohet në 500 kopje.** Printimi duhet t’i përmbahet këtyre specifikimeve:

- Formati B5 (24x16.8)
- Letër e brendshme 120 gr;
- Raporti do të printohet dhe botohet me ngjyra nga brenda (printimi do të realizohet në sasinë 250 kopje shqip dhe 250 kopje anglisht)
- Kapaku letër 250 gr; me ngjyra
- Plastifikim mat me ngjitje (libër-lidhje me ngjitje)
- Sasia: 500 kopje

Realizimi i produktit dhe ofrimi i shërbimit sipas specifikimeve të sipërcituara do të përmbushet brenda muajve Nëntor-Dhjetor 2021, sipas komenteve dhe sugjerimeve të stafit zbatues të projektit.

**Mbështetur nga:**

**Zbatuar nga:**



KShH inkurajon aplikimet nga subjekte/kompani, të cilët janë të interesuar për t'u angazhuar në këtë proces dhe plotësojnë këto kritere të aftësisë individuale, edukimit dhe aftësisë profesionale si vijon:

**KShH fton të gjitha subjektet/kompanitë e interesuara që të dërgojnë në formë elektronike në adresën e e-mailit të KShH-së [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al), deri në datën 23 Nëntor 2021, dokumentacionin e mëposhtëm:**

1. Ofertë financiare në Dollarë (me TVSH të përfshirë)<sup>1</sup>,
2. Oferta duhet të jetë e firmosur dhe e vulosur;
3. Çertifikatë Regjistrimi nëse ofertuesi është kompani/subjekt tregtar;
4. Koha e lëvrimit të produktit sipas kërkesave të sipërcituara.

Dokumentet do të dërgohen në formë elektronike në adresën e e-mailit të KShH-së [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al).

Vetëm subjekti i përzgjedhur do të njoftohet!

Me konsideratë,  
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

---

<sup>1</sup> Subjektet tregtare që nuk janë subjekt i TVSH duhet ta deklarojnë këtë fakt  
**Mbështetur nga:**